



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 35, datë 18.1.2017

P Ë R

**MËNYRËN E FUNKSIONIMIT, TË ORGANIZIMIT
DHE TË SHPËRBLIMIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR
PËR TË DREJTËN E AUTORIT (KKDA)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 156, të ligjit nr.35/2016, datë 31.3.2016, "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Miratimin e mënyrës së funksionimit dhe të organizimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit, (në vijim KKDA), si organ i specializuar, për vendosjen e tarifave të shpërblimit mbi shfrytëzimin e veprave të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në administrimin kolektiv, objekt i përcaktimit të ligjit për të drejtat e autorit.
2. Misioni i KKDA-së është garantimi dhe mbrojtja e mbajtësve të së drejtës, subjekt të të drejtave të autorit, për sa i përket shpërblimit për shfrytëzimin e të drejtave me karakter pasuror ose jopasuror në tregun intelektual.
3. KKDA-ja funksionon në përputhje me parimin e transparencës dhe bashkëpunimit me agjencitë e administrimit kolektiv dhe shoqatat përfaqësuese të përdoruesve.

II. FUNKSIONIMI DHE ORGANIZIMI

1. KKDA-ja është organ kolegjal vendimmarrës dhe këshillimor, pranë ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit dhe përbëhet nga kryetari dhe 4 (katër) anëtarë. Anëtarët e KKDA-së kanë detyrimin të deklarojnë konfliktin e interesit me secilën prej palëve në çdo rast të mundshëm dhe në rast vërtetimi të këtij konflikti detyrohen të mos jenë pjesë e vendimmarrjes në procedurën përpara KKDA-së, sipas legjislacionit në fuqi për konfliktin e interesave. Çdo anëtar, paraprakisht, duhet të deklarojë marrëdhëniet, nëse kanë, me autorët e veprës ose titullarët e të drejtave, AAK-të ose përdoruesit.
2. Emërimi i anëtarëve bëhet nga ministri përgjegjës për të drejtën e autorit, sipas pikës 1, të nenit 156, të ligjit nr.35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, duke marrë parasysh shmangien nga çdo interes direkt ose indirekt të mundshëm të tyre me subjektet që ndikohen nga vendimet e KKDA-së, si dhe duke u bazuar në kriteret e përgjithshme të mëposhtme:
 - a) Të zotërojnë diplomë universitare të ciklit të parë dhe të dytë në fushën juridike, ekonomike, shkencave sociale ose shkencave ekzakte;
 - b) Të kenë njohuri të gjuhës angleze;
 - c) Të kenë më shumë se 5 vite përvojë pune profesionale në fushat e sipërpërmendura.
3. KKDA-ja ka detyrimin që të njoftojë shoqatat e përfaqësuesve kryesorë të përdoruesve ose përdoruesit kryesorë, për të marrë pjesë në seancat ku diskutohet për miratimin e metodologjisë dhe masën e tarifave të shpërblimit për kategorinë e të drejtave përkatëse, të paktën, 5 (pesë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhje. Këto shoqata ose përdorues kryesorë kanë të drejtë të propozojnë dhe të japin opinionin e tyre verbalisht ose me shkrim, por, në asnjë rast, nuk kanë të drejtë vote për vendimmarrje në KKDA.
4. Palët e përmendura në pikën 3 duhet të jenë aktive dhe të gatshme në përgjigjet ndaj KKDA-së për çdo informacion shtesë të kërkuar në funksion të çështjes, objekt vendimarrjeje. Në vendimin përfundimtar KKDA-ja mban parasysh dhe analizon propozimet ose opinionet e shprehura të tyre.
5. KKDA-ja kryen kompetencat në bazë të pikës 4, të nenit 156, dhe ndjek procedurat e miratimit të tarifave të shpërblimit në përputhje me nenin 142 dhe vijues, të ligjit nr.35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.

6. KKDA-ja, përveç sa parashikohet në këtë vendim mund të miratojë rregulloren për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të brendshëm të saj.
7. KKDA-ja shqyrton kërkesat e secilës palë dhe vendos për çdo çështje të ngritur që ka lidhje me objektin e funksionimit të këtij Këshilli.
8. KKDA-ja thërret mbledhjet sipas njoftimit të kryetarit. Mbledhjet janë të vlefshme kur janë të pranishëm të gjithë anëtarët e saj. Në zbatim të shkronjës “a”, të pikës 4, të nenit 156, të ligjit nr.35/2016, numri i mbledhjeve që zhvillon KKDA-ja, si rregull, është 5 (pesë).
9. Kryetari thërret mbledhjet e KKDA-së “*ad hoc*” ose pasi ka vlerësuar kërkesën e paraqitur në zbatim dhe në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.35/2016, për kompetencat e tjera të përcaktuara në pikën 4, të nenit 156, të këtij ligji, përveç atyre të përcaktuara në shkronjën “a” të këtij neni. Në çdo rast, kryetari duhet të tregojë arsyet e mbledhjes apo të refuzimit të kërkesës për mbledhjen e KKDA-së.
10. Në rast të mosarritjes së kuorumit të kërkuar, sipas pikës 8, kryetari thërret mbledhjen pasardhëse jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë nga data e anulimit të mbledhjes. Kryetari ndërmerret të gjitha masat paraprakisht në mënyrë që mbledhja e radhës të zhvillohet normalisht për objektin për të cilën është thirrur.
11. Njoftimit për thirrjen e mbledhjes i bashkëlidhet rendi i ditës dhe materialet e çështjeve për të cilat do të diskutohet në mbledhje. Rendi i ditës miratohet nga kryetari, pas propozimit të sekretarisë teknike të KKDA-së (Drejtoria për të Drejtën e Autorit) apo të anëtarëve të Këshillit. Njoftimi, ku përcaktohen rendi i ditës dhe materialet që do të diskutohen në mbledhje, përgatiten dhe njoftohen nga sekretaria teknike, të paktën, 5 (pesë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhje. Në raste të veçanta, kur për një gjë të tillë bien dakord shumica e anëtarëve të KKDA-së, mbledhja mbahet edhe më parë se data e njoftimit.
12. Mbledhjet e KKDA-së drejtohen nga kryetari.
13. Me shumicën e anëtarëve, KKDA-ja duke marrë edhe mendimin e palëve, mund kërkojë ndihmën e një eksperti për çështje të veçanta, objekt i vendimmarrjes nga ky Këshill, të cilat janë specifike dhe kërkojnë nevojën e ekspertizës profesionale dhe shkencore në funksion të vendimmarrjes së KKDA-së. Kryetari thërret ekspertin dhe përcakton me vendim modalitetet e

paraqitjes së raportit të tij para KKDA-së. Në këtë rast palët mbulojnë në mënyrë të barabartë koston e ekspertimit në procedurën përpara KKDA-së sipas urdhrorit të ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit në zbatim të nenit 146, të ligjit nr.35/2016.

14. Sekretaria teknike e KKDA-së (DDA) mban procesverbalin e mbledhjeve, i cili përfshin:

- a) orën, datën, vendin e mbledhjes;
- b) listëprezencën e pjesëmarrësve në mbledhje;
- c) çështjet e diskutuara nga anëtarët e Këshillit;
- ç) formën dhe rezultatin e votimeve;
- d) çdo informacion apo dokument, objekt diskutimi dhe vendimmarrjeje.

15. Procesverbali u paraqitet për shqyrtim e miratim anëtarëve të Këshillit në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Në rastet kur çështjet e propozuara zgjasin më shumë se një mbledhje, procesverbali miratohet nga anëtarët e Këshillit në përfundim të mbledhjes përkatëse.

16. Vendimet e KKDA-së merren me votim të hapur dhe duhet të jenë të arsyetuara. Anëtarët e KKDA-së në mbledhje dhe që nuk kanë ndonjë pengesë ligjore apo rrethana të tjera për të votuar, nuk mund të abstenojnë. Në vendimin e KKDA-së përcaktohet edhe mbulimi i shpenzimeve nga palët sipas nenit 146, të ligjit nr.35/2016 për të drejtat e autorit.

17. Anëtarët e KKDA-së, që janë të pranishëm në mbledhje, diskutojnë dhe votojnë për vendimmarrjen e një çështjeje të caktuar, me përjashtim të rasteve kur kanë pengesë ligjore në kuptim të nenit 30, të ligjit nr.44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", konfliktit të interesit, diskriminimit ose rasteve të tjera të ndaluara me ligj. Në këto raste, anëtari i Këshillit njofton kryetarin për mospjesëmarrjen në diskutimin dhe votimin e çështjes së caktuar që pritet të zhvillohet në mbledhjen e Këshillit.

18. Kryetari i KKDA-së voton i fundit. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare. Vendimet merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të saj. Vendimet e KKDA-së nënshkruhen nga kryetari.

19. KKDA-ja publikon në vendimin e marrë edhe mendimin e arsyetuar të anëtarit/anëtarëve që kanë votuar në pakicë dhe shënon në procesverbal faktin dhe arsyet e votimit kundër të vendimit.

20. Në rastet e dorëheqjes, ndërprerjes së mandatit apo çdo rrethane tjetër që e pamundëson votimin e anëtarit në mbledhje në procedurën përpara KKDA-së, vendimi merret me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve në detyrë. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e kryetarit përbën shumicën absolute të vendimmarrjes.

III. SHPËRBLIMI I ANËTARËVE TË KKDA-së

1. Shpërblimi për pjesëmarrje në mbledhje, për çdo anëtar, bëhet sipas përcaktimeve të bëra në vendimin nr.418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njëjësive të qeverisjes qendrore", i ndryshuar.
2. Ngarkohet Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

NIKO PELESHI

MINISTRI I KULTURËS

MIRELA KUMBARO FURXHI

NR.PROT.7012/13
DATË 13.1.2017

MINISTRISË SË KULTURËS
MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
MINISTRISË SË FINANCEVE
MINISTRISË SË DREJTËSISË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

